



Hamdi Mramori Street, #1
Prishtina 10000– Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247615 ext 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Sipas autoritetit të dhënë nga Neni 23 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në një sesion të mbajtur më 17.01.2006 ka miratuar

PASQYRË E TAKSAVE

KAPITULLI 1: Kushtet e Përgjithshme

Neni 1 Shtrirja

Kjo Rregullë specifikon kategoritë dhe shumën e taksave të përcaktuara në Nenet 23 dhe 24 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë për qëllimet e financimit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), si dhe procedurat dhe afatet përfundimtare për pagimin dhe pasojat për mospagimin e këtyre taksave.

Neni 2 Përcaktimet

Termet e përdorur në këtë Rregullë, do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në Ligjin për Energjinë, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe Ligjin për Energjinë Elektrike, dhe çdo legjislacion mbi ngrohjen qendrore ose gazin natyror, dhe të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të tjera të zbatueshme në Kosovë.

Neni 3 Kategoria e Taksave

Sipas kushteve të Nenit 24 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja është e autorizuar që të mbledhë kategoritë e mëposhtme të taksave:

1. Taksat fillestare të licencimit.
2. Taksat vjetore të licencimit.
3. Taksat për nxjerrjen e certifikatave të origjinës.
4. Taksat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 4 Parimet e përgjithshëm në lidhje me përlogaritjen e taksave

- 4.1 Taksat e licencës vjetore do të përcaktohen në mënyrë të atillë, që lejojnë vetë-mbështetje financiare dhe aktivitet efektiv dhe efikas të ZRRE-së, dhe në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë një shumë ekuivalente të 2% të “qarkullimit bruto” të ndërmarrjeve energjetike, të cilave iu kërkohet që të paguajnë këto taksa vjetore. Për nevoja dhe kushte të sektorit të energjisë në Kosovë, ”qarkullimi bruto” nënkupton vleften e përgjithshme të Shitjes të një ndërmarrje nergjetike.
- 4.2 Metodologjia për llogaritjen e taksavet vjetore të licencave, e të përcaktuara në Shtojcën A, merr në shqyrtim kushtet e sektorit të energjisë në Kosovë dhe fazën zhvillimore të ZRRE-së, bazohet në kriterin e aplikueshmërisë dhe thjeshtësisë, si dhe synon të shmangë çdo rrezik të mbingarkimit financiar të konsumatorëve.

- 4.3 Taksat për nxjerrjen e certifikatave të origjinës do të llogariten në përputhje me shpenzimet administrative të arsyeshme, që paraqiten gjatë procedimit të akteve, të cilave iu referohen këto taksa.

Neni 5

Vlefte e taksave

Shuma e saktë e taksave përkatëse do të përcaktohet në përputhje me Shtojcën A të kësaj rregulle, që është pjesë integrale e tij.

KAPITULLI 2: Kategoritë e Taksave

Neni 6

Taksat fillestare të licencimit

Taksat fillestare të Licencimit përbëhen nga taksat administrative, të përshkruara për nxjerrjen ose ndryshimin e licencave, duke përfshirë edhe shpenzimet për përgatitjen e këtyre licencave, në përputhje me kushtet e Neneve 28 dhe 35, paragraf a), të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 7

Taksat vjetore të licencimit

7.1 Taksat vjetore të licencimit janë shpenzimet e parashikuara për kryerjen e aktiviteteve të rregulluara në sektorin e energjisë që nga momenti i lëshimit të Licencës dhe për çdo vit pasues, pas vitit të lëshimit të licencës.

7.2 Taksat vjetore të licencimit përfshijnë një shumë të ndryshueshme, që do të llogaritet në përputhje me aktivitetin përkatës vjetor në sektorin e energjisë, dhe në bazë të rrjedhjeve të vlerësuara të energjisë gjatë vitit aktual.

7.3 Taksat vjetore të licencave, do të futen vetëm për Gjenerues të energjisë dhe do të llogariten në bazë të energjisë së matur neto, që është futur në rrjet (Energjia elektrike dhe Ngrohja Qendrore).

Për sa i përket Gjenerimit të energjisë elektrike, kjo është e matur në anën e rrjetit të tensionit të lartë të bllok-lidhjes Transformator-Gjenerator.

Prodhimi i ngrohjes është i matur në “pikën-ndarëse” ndërmjet Ngrohtores dhe rrjetit Shpërndarës.

Tregtarëve të Interkoneksionit (ndërlidhjes) gjithashtu, do t’u vendoset tarifa vjetore e licencave në bazë të kontratës dhe importit të realizuar.

Taksat vjetore të licencave janë të shpërndara në llogarinë e bartësve të Licencës për Gjenerim, Licencës për Ngrohje Qendrore dhe Licencës të Tregtarëve të Interkoneksionit.

7.4 ZRRE-ja do të llogarisë taksat vjetore të licencave për mbajtësit e Licencave të Gjenerimit dhe Ngrohjes Qendrore, duke u bazuar në vlerësimet e rrjedhave të energjisë së përgjithshme të futur gjatë vitit kalendarik pasues, dhe do t’i njoftojë të gjithë Prodhuesit dhe Ngrohjet Qendrore të licencuara mbi këtë shumë, prej 1 dhjetorit të vitit paraprak..

Në rast të Licencave të reja ose ndryshimeve në Licencat ekzistuese, për pjesën e mbetur të vitit aktual, ZRRE-ja do të rillogarisë taksat përkatëse vjetore, bazuar në rrjedhjet reale të energjisë, siç është përcaktuar në përputhje me dispozitat e Kodit të Matjes. Barazimi i çfarëdo ndryshimi ndërmjet shumës së parapaguar dhe shumës reale që duhet paguar, do të kryhet njëkohësisht me pagesën e taksave vjetore të licencave që duhen paguar për vitin e ardhshëm.

- 7.5 Të Licencuarve për Gjenerim dhe Tregtarëve të Ndërlidhjes, të cilëve iu kërkohet që të shesin energji tek bartësi i një licence të furnizimit publik me një çmim të rregulluar, do të kenë të drejtën të përfshijnë kostot e taksave të licencave vjetore që kanë të bëjnë me këtë sasi të energjisë me çmime të rregulluara.

Neni 8

Taksat për nxjerrjen e certifikatave të origjinës

Taksat për nxjerrjen e certifikatave të origjinës, përfshijnë shpenzimet për përgatitjen e këtyre certifikatave. Kjo është një pagesë shtesë mbi taksat e tjera, që i Licencuari duhet të paguajë si rezultat i aplikimit të Rregullës aktuale.

Neni 9

Taksat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe lejeve

- 9.1 Taksat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, janë shpenzime të vendosura për arbitrim, në përputhje me Kapitullin 5 të Rregullës mbi Procedurat për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve.
- 9.2 Taksa për lëshimin e lejeve fillestare dhe përfundimtare vendosen në pajtim me rregullën e Procedurës së Autorizimit.

Kapitulli 3: Rregullat procedurale

Neni 10

Procedura për mbledhjen e taksave

- 10.1 Taksat për shqyrtimin e aplikacioneve do të paguhën në kohën e dorëzimit të aplikacionit dhe duhet të paguhën pavarësisht nga vendimi i ZRRE-së në lidhje me të.
- 10.2 Taksat fillestare të licencimit dhe taksat për nxjerrjen e certifikatave të origjinës, do të paguhën në paradhënie dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarik, prej marrjes së një fature të lëshuar nga ZRRE-ja.
- 10.3 Taksat vjetore të licencave do të paguhën brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarik, prej marrjes së faturës të lëshuar prej ZRRE-së. ZRRE-ja mund të lejojë pagimin e këtyre taksave përmes pagesave me këste mujore, siç përshkruhen në çdo licencë

Neni 11

Mënyrat e Pagimit

- 11.1 Përveç taksave vjetore që duhet të paguhën drejtpërdrejt në llogarinë bankare të ZRRE-së, të gjitha taksat tjera do të paguhën me të holla të gatshme ose me anë të depozitimit në llogarinë bankare të ZRRE-së.
- 11.2 Për çdo pagesë të bërë në të holla të gatshme, ZRRE-ja do të japë dëftesën e pagesës dhe do të mbajë një kopje të saj.
- 11.3 Për çdo pagesë të depozituar në bankë, dëftesa e depozitimit do të dorëzohet në ZRRE.

Neni 12

Pasojat e mospagimit

- 12.1 ZRRE-ja ka të drejtën të mohojë shqyrtimin e aplikacioneve për nxjerrjen ose ndryshimin e licencave, e që nuk shoqërohen me një faturë të pagimit të taksave përkatëse.

- 12.2 Duke mos i cenuar kushtet e Nenit 12.1, për rastin kur dështohet të bëhet pagesa e taksave përkatëse, ose nuk është arritur të bëhet një marrëveshje e kënaqshme pagimi në pajtim me kushtet e kësaj Rregulle, ZRRE-ja do të njoftojë me shkrim debitorin, duke i siguruar atij edhe një afat përfundimtar të paktën prej dhjetë (10) ditëve kalendarike. Në rast të mospagimit deri në skadimin e këtij afati, ZRRE-ja mund të refuzojë aplikacionin.
- 12.3 Ndërmarrja e energjisë e cila nuk e paguan pagesën e licencës brenda afatit të vendosur nga ZRRE-ja, do të jetë subjekt i gjobave të vendosura nga ZRRE-ja në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
- 12.4 Në përputhje me Nenin 12.3, në rast të mospagimit të taksave vjetore për licencë, ZRRE-ja mund të detyrojë të paguajë interes në varësi nga shumta, me një normë e cila i referohet normës bankare prej 2 % për muaj. Për këtë qëllim, ZRRE-ja do të njoftojë të licencuarin me shkrim.
- 12.5 Në përputhje me Nenin 12.4, në rast të mos pagesës së mëtejshme, ZRRE-së mund ta tërheqë licencën por duke i mundësuar atij që rastin ta zgjidhë me procedurë ligjore.

Neni 13

Ankesat përpara ZRRE-së

- 13.1 Debitori i këtyre taksave, pas marrjes së njoftimit mbi shpenzimet përkatëse, ka të drejtën të depozitojë një ankesë përpara ZRRE-së, brenda një afati përfundimtar që nuk i kalon dhjetë(10) ditë kalendarike.
- 13.2 ZRRE-ja është e detyruar të regjistrojë këtë ankesë dhe të vendosë në lidhje me të, brenda një afati përfundimtar që nuk i kalon dhjetë (10) ditë kalendarike.
- 13.3 Dorëzimi i ankesës, nuk pezullon detyrimin për të paguar taksat, përveç nëse lejohet ndryshe nga ZRRE-ja.
- 13.4 ZRRE-ja mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht detyrimin për të paguar taksat, deri në një vendim përfundimtar mbi ankesën. Në këtë rast, debitori do të njoftohet me shkrim.
- 13.5 Pezullimi i detyrimit për të paguar taksat do të lejohet në rast të ankesave të arsyetuara qartë.

KAPITULLI 4: Kushtet përfundimtare dhe të përkohshme

Neni 14

Gjuha zyrtare e Rregullës

- 14.1 Kjo Rregull është nxjerrë në shqip, serbisht dhe anglisht.
- 14.2 Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, do të mbizotërojë versioni anglisht.

Neni 15

Hyrja në fuqi-Amendamentet

- 15.1 Kjo Rregull hyn në fuqi, në datën e publikimit të tij në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, përveçse nëse specifikohet ndryshe.
- 15.2 ZRRE-ja mund të procedojë për ndryshimin e kësaj Rregulle, nëse e sheh si të nevojshme.
- 16.3 Pa paragjykim ndaj Nenit 15.2, kjo Rregull nuk do të ndryshohet para skadimit të një periudhe pesë (5) vjeçare, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, të shoqëruara me përlogaritje të taksave, bëjnë të nevojshëm një ndryshim më të hershëm.

SHTOJCA A: TAKSAT PËR ZYRËN E RREGULLATORIT TË ENERGJISË

Kategoritë e Taksave	Taksat në EURO (€)
A. Taksat fillestare të aplikimit (Neni 6)	
A.1 Aplikimi i ri ose i rishikuar me ndryshime komplekse për Licencë të Gjenerimit të Energjisë Elektrike	
A1.1 deri në 50 MW dhe rishikim me ndryshime komplekse	€ 3000
A1.2 tejkalon 50 MW por është më i vogël se 400 MW	€ 6000
A1.3 400 MW e sipër	€ 12000
A.1.4 Rishikime me ndryshime të thjeshta	€ 750
A.2 Licenca për Furnizim Publik dhe Licenca e Furnizimit/Tregtarëve	
A.2.1 nën 100 MW	€ 2000
A.2.2 tejkalon 100 MW por më e vogël se 400 MW	€ 3000
A.2.3 mbi 400 MW	€ 5000
A.3 Licenca për Operator Tregu	€ 3000
A.4 Licenca për OST and OSSH	€ 6000
A.5 Licenca për Gjenerim të Ngrohjes Qëndrore	€ 500
A.6 Licenca për Distribimin e Ngrohjes Qëndrore	€ 500
A.7 Licenca për Furnizim me Ngrohje Qëndrore	€ 500
A.8. Rishikimi në lidhje me A.2-A.7	€ 500
B. TAKSAT VJETORE TË LICENCIMIT (Neni 7)	
B.1 Prodhimi i energjisë elektrike, importi <i>(futja neto në rrjet për gjeneratorët dhe energjia e kontraktuar dhe e realizuar për tregtarët ndërlidhës)</i>	€ 0.22/MWh
B. 2. Prodhimi i energjisë termike, <i>(futja neto në rrjet)</i>	€ 0.1/MWh
C. TAKSA PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË ORIGINËS (Neni 8)	€ 0.05/MWh
D. TAKSAT E VENDOSURA PËR ZGJIDHJEN E MOS-MARRËVESHJEVE DHE LEJEVE	
D1. Taksat e arbitrimit	Në përputhje me marrëveshjen
D2. Taksat për Leje	Në pajtim me Rregullën e Autorizimit

